

KËRKIME GJUHËSORE

Teuta ÇOKU

MJETET LIDHËSE NË PERIUdhËN PËRCAKTORË NË VEPRËN “CUNEUS PROPHETARUM” TË PJETËR BOGDANI

ABSTRAKT: Vepra “Cuneus Prophetarum” është një prozë origjinale në të cilën dëshmohet denduria e përdorimit të periudhave me nënrenditje, ku një vend të veçantë zë edhe fjalia me nënrenditje përcaktore. Objekti i këtij punimi është periudha me nënrenditje përcaktore e përdorur në veprën e Bogdanit, në prozën shkencore dhe atë artistike. Në këtë punim fjalinë përcaktore e kemi shqyrtuar në një vështrim diakronik, duke iu referuar gjuhëtarëve që janë marrë me historinë e gjuhës shqipe, si: E. Çabej, Sh. Demiraj, K. Topalli. Nisur nga ky vështrim kemi evidentuar dendurinë e përdorimit të fjalisë me nënrenditje përcaktore në veprën “Cuneus Prophetarum” të Bogdanit. Duke u mbështetur në analizat që kemi bërë te kjo vepër kemi evidentuar mjetet e lidhjes dhe stukturat e fjalive nënrenditëse përcaktore. Fjalia përcaktore rezultoi e lidhur me fjalë lidhëse, përemra dhe ndajfolje lidhore, si dhe me lidhëza filluese. Fjalia përcaktore apo lidhore siç quhet në gramatikat e vjetra, në veprën e Bogdanit shfaqet me rend të ndërvendosur dhe të prapavendosur. Përsa i përket topikës së fjalisë përcaktore, kemi evidentuar rastet e lidhjeve imediate dhe mediate që ka kjo fjali me paraprijësin që ndodhet te fjalia drejtuese.

FJALË ÇELËS: periudhë, mjete lidhëse, fjalë lidhëse, lidhëz, topikë.

ABSTRACT: The work “Cuneus Prophetarum” is an original prose in which is evidenced the dense use of the subordinate phrases, where a special place gets the use of determinant phrases. The object of this work is the subordinated determinative phrase used in Bogdani’s scientific and artistic prose. In this prose we had the subordinate sentence studied in a diachronic sightseeing referring to the other linguists like: E. Çabej, Sh. Demiraj, K. Topalli. Starting by this sightseeing we have evidenced the dense of using the sentence with subordinate phrase in “Cuneus Prophetarum”. Starting from the analyses at this prose we have evidenced the connecting tools and the structures of the sentences with subordinate. The determinate sentence results connected with linked words, pronouns and subjunctive adverbs connectors. Another important aspect that we have noticed in this analysis is the word order. Regarding to the topic of the sentences we have seen cases of mediate, immediate topics.

KEY WORDS: Long sentence, linking words, topic connectors.

Vepra “Cuneus Prophetarum” e Bogdanit është një vepër origjinale që i përket letërsisë së vjetër. Duke studiuar strukturën e periudhave me bashkërenditje dhe nënrenditje, ajo që na tërhoqi vëmendjen për ta shqyrtuar në këtë punim është fjalia përcaktore. E parë në një vështrim diakronik, vetë nënrenditja është zhvilluar më vonë se bashkërenditja. Sipas Çabejt fillimet e nënrenditjes në gjuhët e

dëshmuara herët janë modeste. E vetmja fjali e dëshmuar herët është fjalia lidhore, fjalia relative.¹ Fjalia lidhore, si një ndër fjalitë me nënrenditje që del në dokumentet më të lashta të indishtes, greqishtes e latinishtes lidhej me një përemër lidhor.² Kjo fjali lidhet me përemrin lidhor *që*, në vepër ai shfaqet me trajtën *qi*. Ky përemër përfaqëson një formë përemërore të trashëguar.³ Fjalia përcaktore rezultoi e lidhur edhe me përemrin *i cili* që shfaqet me trajtën *i silli*. Ky përemër është formuar nga bashkimi i dy elementeve përemërore.⁴ Duke lidhur një fjali të nënrenditur përcaktore me një gjymtyrë të fjalisë drejtuese, këta përemra marrin një kuptim të caktuar, prandaj Sh. Demiraj i quan përemra lidhorë me kufij të caktuar.⁵

Periodha me fjali të varur përcaktore është ajo periudhë ku fjalia e varur tregon në përgjithësi një karakteristikë të një sendi të shprehur nga një gjymtyrë emërore e cila është paraprijësi i saj.⁶ Në gramatikat e mëparshme kemi emërtime dhe përkufizime të tjera.

J. Rrota e quan fjalia e atributit, që vjen si atributi për të zhvilluar a caktuar një emër.⁷ Ndërsa K. Cipo e emërton fjali lidhore që mbështetet pas një substantivi.⁸ Edhe M. Domi i quan fjali lidhore ato fjali që lidhen me përemër lidhor dhe shërbejnë për cilësuar a sqaruar kuptimin e një emri a përemri të një fjalie tjetër.⁹ Në veprën “Çeta e Profetëve” fjalia përcaktore zë një vend të veçantë në krahasim me fjalitë e tjera.

Mjetet lidhëse që shërbejnë për të lidhur fjalinë me nënrenditje përcaktore me fjalinë drejtuese në veprën e Bogdanit janë:

1. fjalët lidhëse, përemrat dhe ndajfoljet lidhore
2. lidhëzat fthilluese.

1.1 Përemrat lidhorë që shërbejnë për të lidhur fjalinë përcaktore në vepër janë; *qi*, *i cili*, *e cila*.

Përemri *qi* del i pandryshueshëm, pasi nuk ka trajta të veçanta për gjininë, numrin dhe rasën. Kështu që funksioni i tij përemëror nuk del i qartë, vetëm kur është kryefjalë a kundrinë e drejtë në fjalinë e varur del qartë funksioni i tij.

... qish mos ashtë goditunë kurraj ndër nierëz, /*qi lenjëne tue kjam...*(CP, f. 4, shk. 1, ligj. 1, pj. 1)

Sa të mërztunë e mëni ka Zotynë përmbi këtë mpkat të magjivet, /*qi të pafetë mbanë për shejtëni e nder të madhe...*(CP, f. 4, shk. 1, ligj. 1, pj. 1)

...e mbë qiellt u ndienë kankë engjijësh/ *qi thojnë disa barijve...* (CP, f. 35, shk. 1, ligj 7, pj. 2)

¹ E. Çabej, *Hyrje në indoeuropianistikë*, Leksionet e Prishtinës, 2008, f. 228.

² K. Topalli, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2011, f. 1182.

³ Po aty, f. 1186.

⁴ Po aty, f. 1186.

⁵ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1985, f. 510.

⁶ *Gramatikë e gjuhës shqipe*, II, Tiranë, 1997, f. 525.

⁷ J. Rrota, *Sintaksi i shqipes*, Shkodër, 1942, f. 80.

⁸ K. Cipo, *Sintaksa*, Tiranë, 1952, f. 92.

⁹ M. Domi, *Gramatikë e gjuhës shqipe*, II, Tiranë, 1957, f. 161.

MJETET LIDHËSE NË PERIUDHËN PËRCAKTORE NË
VEPRËN “CUNEUS PROPHETARUM” TË PJETËR BOGDANI

Fjalja përcaktore mund të plotësojë kuptimin jo vetëm të një emri, por edhe të një përemri të ndodhur në fjalinë drejtuese.

Kështu ende aj/ qi të doj me vum roe të ngjitunitë/ qi kanë ndër vetëhe kreatyrëtë... (CP, f. 2, shk. 1, ligj. 1, pj. 1)

...banë kshill me shtim faret gjithë ata, /qi t'ishinë ende së largu fisit së Davidit... (CP, f. 2, shk. 1, ligj. 1, pj. 2)

... se ata /qi gjëllijnë nd atë pjesë dheu të Misirit... (CP, f. 5, shk. 1, ligj. 1, pj. 1)

Mes fjalive përcaktore të lidhura me përemrin lidhor *qi* shfaqen edhe marrëdhënie parataktike, por ajo që vëmë re në këtë vepër është mospërsëritja e përemrit lidhor dhe zëvendësimi i tij me përemrin *ato*: Aso së katër vërtytesh së elementave /qi janë kundër shoqeja shoqesë/, e ato janë të nxetitë, të ftofëtitë, të thatitë e të njomëtë (CP, f. 37, shk. 1, ligj. 5, pj. 1)

Përemri lidhor *i cili*, *e cila*, funksionalisht i njëjtë me përemrin lidhor *që*, ka trajta të veçanta për të treguar gjininë, numrin dhe rasën. Ai shpreh lidhje sintaksore të dyfishta me paraprijësin, përshtatet në gjini, numër dhe vihet në atë rasë që e kërkon funksioni i tij në fjalinë e varur.

...të digjej ndë një furrë aqa të madhe/, sa flaka e sajnaj mbërrintë 49 kut nalt/, ndë të sijët bani me shtim Isaknë, Misaknë et Abdenago, /të sijtë kjenë shpëtue me prej Sinezot, tue kënduem... (CP, fq.3, shk.1, ligj.1, pj.1)

...tue përvum krahët e mendsë e shqisesë sanë fjalëvet tinaj /të sijatë kurraj palëvi e rrenë nukë kanë . (CP, f. 6, shk. 1, ligj. 1, pj. 1)

se ka një Zot/, i silli me të madhe urti i ka gjithë krijuem e ruejtunë /; (f. 2, shk. 1, ligj. 1, pj. 1)

Nga analizat e bëra kemi vënë re përdorimin në rasa të ndryshme të përemrit lidhor *i cili*, *e cila*:

- në rasën emërore: ashtë Hyj, Shpirti Shejt / *i silli rrjedh së dysh* (CP, f. 9, shk. 1, ligj. 2, pj. 1)

Tue kjanë rreza e ngushëllimit e shembëlltyra e vetëhesë/, *e silla tue mos mujtunë me kjanë dam Hyjit* (CP, f. 8, shk. 1, ligj. 2, pj. 1)

- në rasën dhanore, që del me trajtën *t'sillt*.

...e se ndryshej nukë mundetë me kjanë /, tash me të Shkruemit Shent/, *t'sillit nukë mundemi me kundërshtuem*/, po lëftojmë me kallëzue... (CP, f. 12, shk. 1, ligj. 3, pj. 1)

- në rasën kallëzore:

fort i bëgatë, për emënë Serafano, kishte një bir/ *të sillinë doj mirë përmbi gjithë kafshë të kësaj jete* (f. 3, shk. 1, ligj. 1, pj. 1)

- në rasën rrjedhore që del me trajtën: *së sillet*, *së sillësh*

Prandaj/ me bam mirë përket natyrësë/, e pëlqen vullëndetsë sanë/, *së sillet rrjedh shija...* (CP, f. 30, shk. 1, ligj. 6, pj. 2) Ashtu qi me ma të madhe dhunë të Djallit, asish/ *së sillësh desh aj me u lëvduem* /, Krishti e shejtënit e tinaj të ndereshinë... (CP, f. 31, shk. 1, ligj. 6, pj. 2)

ashtu qi me të përkorë të gjellësë , të prunvej mishi, tue u përtham ato avulla të këqia /*së sillashit rrjedhënë gjithë mpmatetë* (CP, f. 39, shk.1, ligj. 8, pj. 2)

Përemrit lidhor si fjalë lidhëse shfaqet edhe i shoqëruar me parafjalë të ndryshme, p.sh:

I dyjti vetë ndë Tenezonë vjen emënuem Dijeja, /me të sijët thonë/ kje krijuem shekulli... (CP, f. 16, shk. 1, ligj. 3, pj. 1)

E silla asht këjo dije jashtë asaj së naltit Zot,/për të sillt thotë Solomoni... (CP, f. 4, shk. 1, ligj. 1, pj. 2)

...leu prej Anet e lumeja gjithëherë Virgjinë Mri, ndë gjytet të Naxaretit, nd atë të njimendë shtëpi/, ndë të sijët kje ende zanë...(CP, f. 5, shk. 1, ligj. 2, pj. 2)

I gjashti qiell ashtë i Jovit e thonë se ky yll ashtë 91 herë ma i madh se dheu, ashtë i ndriçim e i bardhëMbi të sillëdo shenj ndaletë për një vjet t'ungjinë (CP, f. 25-26, shk. 1, ligj. 4, pj. 1) (mungon paraprijësi që ndodhet te fjalia tjetër dhe fjalia fillon me pjesë të nënrenditur përcaktore)

Për detyrë pra të shëlbyemit tinë, duhetë për gjithë ditë me kallëzue ndë jetët tanë kund një vizë të re/, ndëpër të sillët të mundemi me u shëmbëlllyem jetesë Krishtit shembëlltura e gjithë shejtënisë... (CP, f. 42, shk. 1, ligj. 8, pj. 2)

1.2 Ndajfoljet lidhore kryejnë funksionin e përmendjes së emrit paraprijës. Ato kanë rol të dyfishtë; si mjet lidhës dhe si gjymtyrë e fjalisë së varur.

Ndajfolja lidhore që rezulton e përdorur më shumë në vepër është ndajfolja *ku* që tregon vend:

...e u mbëlodh mbë vendtë/, *ku i urdhënoj Zotynë/* ... (CP, f. 33, shk. 1, ligj. 5, pj. 1)

Gjiu i Abramit ashtë faqeja e dheut/ *qi të parëtë i thojnë Fushat e Elizit/ e aty patnë mbetunë print e parë, Patriarkët e profetëtë/*, parë se kje çelë Parrisi me mundi të Jezu Krishtit Zotit tinë. (f. 34, shk. 1, ligj. 5, pj. 1) (në vend të ndajfoljes lidhore *ku*, përdoret *e aty*)

Një tjetër ndajfolje lidhore e përdorur në vepër dhe që tregon vend është ndajfolja *kahë*, e cila përmendet te sintaksa e J. Rrotës, ndërsa në gramatikat e sotme nuk gjen përdorim:

..e i S.Jozefi kthej asaj udhe /*kahë kishinë zakon burratë* ... (CP, f. 33, shk.1, ligj. 7, pj. 2)

...tue çuem syt prej qiellshit,/kahë kje rrëzue...(CP, f. 41, shk. 1, ligj. 8)

Ndajfolja lidhore *kur* përdoret me emra paraprijës me kuptimin leksikor të një fragmenti kohor, si *ditë, natë*.¹⁰

E prashtu S. Amë Kishë feston atë ditë/ *kur kthej Krishti prej Misiri ,shtatë dit ndë kallënduer*... (CP, f. 32, shk. 1, ligj 6, pj. 2)

Natet/*kur leu Jezu Krishti /u duk një re aqa e ndriçime* ... (CP, f. 22, shk. 1, ligj. 4, pj. 2)

Por në vepër kemi ndeshur edhe raste të përdorimit të përemrit lidhor *qi* në vend të ndajfoljes *kur* me po ato paraprijës, p.sh:

...u rrëzue aso nateje /*qi leu Jezu Krishti*...(CP, f. 23, shk. 1, ligj. 4, pj. 2)

Aso diteje/ *qi leu Jezu Krishti/ leu një yll prej së dalit*...(CP, f. 22, shk. 1, ligj. 4, pj. 2)

¹⁰ Gramatikë e gjuhës shqipe, II, Tiranë 1997, f. 527.

MJETET LIDHËSE NË PERIUDHËN PËRCAKTORE NË
VEPRËN “CUNEUS PROPHETARUM” TË PJETËR BOGDANI

Si ndajfolja lidhore përdoret edhe ndajfolja **si** që përdoret vetëm pranë emrit mënyrë.¹¹ Kurse M. Domi i pranon këto ndajfolje si lidhore kur mund të zëvendësohen me një përemër lidhor të shoqëruar me parafjalë.¹²

Zotynë ende e soditënte me rreze të shumë driteje prej qiellshit, e me *nji dashunë* përmbi gjithë kreatyrë të vet *,/si duhej për nji të denjë amë të Birit të vet.* (CP, f. 8, shk. 1, ligj. 2) (qi duhej...)

...tue dhanë nji shenj/ *si kishinë për të gjetunë e për ta njofunë...* (CP, f. 21, shk. 1, ligj. 4, pj. 2)

Në këtë rast ndajfolja ka si paraprijës emrin *shenjë*, por mund të zëvendësohet me përemrin *me të cilën*.

2. Në veprën e Bogdanit fjalitë përcaktore shfaqen të lidhura edhe me lidhëzat filluese **se, qi**. Këto fjali përcaktore lidhëzore e përcaktojnë paraprijësin emër jo nëpërmjet një tipari a veçorie, por nëpërmjet ffillimit të brendisë konkrete të emrit.¹³ Fjalitë përcaktore që lidhen me lidhëzat filluese përbëjnë një grup më vete te sintaksa e M. Domit i cili i emërton *fjali caktuese*.¹⁴

2.1 me lidhëzën filluese *se*:

...si të vërtetë fjala /se Krishti ashtë i vërteti Mesi, giunit së Abramit/, të sillinë përmetoj Zotynë me dërguem... (CP, f. 24-25, shk. 1, ligj. 5, pj. 2)

...për të na dhanë neve shembëlltyrë/, **ndë se duhetë me shpenxuem motnë** (CP, f. 36, shk. 1, ligj. 7, pj. 2).¹⁵

2.2 me lidhëzën filluese *qi*, e cila mund edhe të mos shprehet:

Prashtu bani kusht fort të shtrejtë, /kurraj me mos u martuem, / po tue falë Tinëzot bukurine vet e virgjininë, gjithë kje dhanë shpirtit. (CP, f. 8, shk. 1, ligj. 2)¹⁶

Ajo fjalë :/qi mbë qiell të lenjë drita merretë vesht (CP, f. 2, shk. 1, ligj. 1, pj. 2)

Rendi i fjalisë lidhore-përcaktore në veprën e Bogdanit rezulton i prapavendosur, meqenëse pjesa përcaktore ndodhet ngjitas me paraprijësin i cili ndodhet në fund të pjesës drejtuese, por edhe i ndërvendosur: Ma aj /qi ashtë mbë qiell të nalt atje Hyji me engji/,... kurrë nukë duhej me pasë nevojë (CP, f. 30, shk. 1, ligj. 6, pj. 2)

Nuk janë të pakta rastet e shqyrtuara kur këtë lloj fjalie e ndeshim me një rend krejt tjetër, jo më ngjitas me paraprijësin, por të vendosur në distancë nga ai:

Tre anëmiq mixorë ka nieri mbë këtë jetë /, të sijtë janë Djalli, mishi o gjaku, e shekulli. (CP, f. 39, shk. 1, ligj. 8, pj. 2)

¹¹ Gramatikë e gjuhës shqipe, II, Tiranë, 1997, f. 527.

¹² M. Domi, Gramatikë e gjuhës shqipe, II, Tiranë, 1957, f. 163.

¹³ Gramatikë e gjuhës shqipe, II, Tiranë, 1997, f. 527.

¹⁴ M. Domi, Gramatikë e gjuhës shqipe, II, Tiranë, 1957, f. 167.

¹⁵ E. Sedaj, Çeta e Profetëve, kthyer në gjuhën e sotme, Drita, Prizren, 1997, f. 119: *se në çka duhet ta shpenzojmë kohën*.

¹⁶ E. Sedaj, Çeta e Profetëve, kthyer në gjuhën e sotme, Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 63: *që kurrë mos të martohet*.

Të tretën ditë,/ tue kjanë dheu gjithë mbëluem me ujë/, nukë kishinë *nierëzitë*/ ku të vendoheshinë,/ për të sijt gjithë kreatyra po bahej. (CP, f. 32, shk. 1, ligj. 5, pj.1)

Ndeshen edhe raste kur paraprijësi ndodhet te fjalia tjetër dhe periudha fillon me një fjali përcaktore, p.sh:

Andyj mirretë vesht të shumët e yjet,/ të sijtë për shumicë të tyne njimendenë me ranë të detit, e veçë Zotynë di/ sa janë. *I silli njehën shumicën e yjet*,/ e gjithë për emënë i thërret (CP, f. 26, shk. 1, ligj. 4, pj.1).

Si përfundim mund të themi se fjalia përcaktore ,si një prej fjalive më të hershme me nënrenditje shfaqet në veprën e Bogdanit si:

fjali përcaktore përemërore,e lidhur me përemrat lidhor: *qi, i silli,e silla* dhe me ndajfoljet lidhore: *ku, kur, kahë, si*.

fjali përcaktore lidhëzore, e lidhur me lidhëzat fthilluese: *se, qi*.

Fjalia përcaktore rezulton me topikë të prapavendosur dhe të ndërvendosur. Mes kësaj fjalie dhe paraprijësit u shfaqën lidhje imediate, por edhe mediate, të cilat i evidentuam në këtë punim.

BIBLIOGRAFI

Bogdani, Pjetër, *Cuneus Prophetarum*, Akademia e Shkencave,Tiranë 2005,
Botim kritik i A. Omari.

Cipo, Kostaq, *Sintaksa*,Tiranë 1952.

Çabej, Eqrem, *Hyrje në indoeuropianistikë*, Leksionet e Prishtinës, 2008.

Demiraj, Shaban,*Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë 1985.

Domi, Mahir, *Gramatikë e gjuhës shqipe* II, Tiranë 1957.

Gramatikë e gjuhës shqipe II, Tiranë 1997.

Rrota, Justin, *Sintaksi i shqipes*, Shkodër 1942.

Sedaj, Engjell, *Çeta e profetëve* I, “Rilindja” Prishtinë 1990.

Sedaj, Engjell, *Çeta e profetëve* II, “Drita” Prizren 1997.

Topalli, Kolec, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë 2011.